

VENDIM
Nr. 576, datë 23.8.2006

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË
PËRDORIM,
TË BASHKISË BURREL, TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore (lidhja 1), që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Burrel, të qarkut të Dibrës, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Burrel, të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr.602, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Burrelit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Burrelit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Burrel
Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
14-20;22;23;26;27;28	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
34-49	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
100-105	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale	Në pronësi
142	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
143-151;185;186-379;384-389;415-427;428-452;453-482;	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike	Në pronësi
86-99	Prona që përdoren në fushën e kulturës dhe sportit	Në pronësi

106;107	Varrezat publike	Në pronësi
152-184	Infrastrukturë (troje)	Në përdorim
54;55;60-79	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik, dhe bujqësisë e ushqimit	Në pronësi
111-122;383	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi